


Fakte rreth Missionit



VJET BASHKË



Rreth nesh

Misioni i OSBE-së punon për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve, për promovimin e qeverisjes së mirë dhe përmirësimin e standardeve të sigurisë publike në Kosovë.

I themeluar në vitin 1999, ky është Misioni më i madh i OSBE-së.

Është e vetmja organizatë ndërkombëtare civile e pranishme në mbarë Kosovën që monitoron nga afër zhvillimet politike e institucionale, ato në drejtësi dhe fushën e sigurisë, dhe jep rekomandime për përmirësimet aty ku është e nevojshme.

Një nga objektivat kryesore të Misionit është zhvillimi i mëtejmë i shoqërisë demokratike dhe shumë-ethnike në Kosovë, ku respektohen të drejtat e seçilit në mënyrë të plotë dhe të barabartë. Në këtë drejtim, Misioni mbështet institucionet dhe sektorin e shoqërisë civile përmes trajnimeve, avokimit, promovimit dhe ofrimit të ekspertizës.

Misioni ka mbështetur themelimin e një numri institucionesh kyçë, duke përfshirë Kuvendin e Kosovës, Institucionin e Avokatit të Popullit, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Zyrën e Komisionerit për Gjuhët dhe organet komunale për mbrojtjen e komuniteteve.

Prania

Misioni ka pesë qendra rajonale: në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, me ekipe terreni që mbulojnë të 38 komunat në mbarë Kosovën.

Mandati

Mandati i Misionit, i përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Vendimin e Këshillit të Përherëshëm të OSBE-së nr. 305 të datës 1 korrik 1999, i jep Misionit "rol udhëheqës në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve, demokracisë dhe të drejtave të njeriut".

Misioni punon ngushtë me misionet e tjera të OSBE-së në Evropën Juglindore për të përmirësuar bashkëpunimin rajonal, dialogun dhe pajtimin.



Misioni organizoi kamp rinoj për studentët e arkitekturës dhe antropologjisë për të zgjeruar njoshitë dhe ndërgjegjësimin e tyre lidhur me vlerat e trashëgimisë kulturore, si dhe përfitimet kulturore, sociale dhe ekonomike që i sjell ajo. Studentët bënë hulumtim dhe dokumentim të gjendjes së Çarshisë së Vjetër në Pejë.



Programi EmPower për gratë politikane të nivelit lokal bazohet në parimet e barazisë, pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënieve, me qëllimin kryesor forcimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave të nivelit lokal në sferën publike dhe në politikë.

Puna jonë

Aktivitetet e Misionit udhëhiqen nga katër parime: integrimi i qasjes shumetnike, tolerancës, dialogut dhe pajtimit; promovimi i barazisë, transparencës institucionale dhe llogaridhënie; qëndrueshmëria; dhe avancimi i të drejtave gjinore, të rinjve dhe komuniteteve.

Misioni avancon barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave përmes të gjitha programeve të veta, ndërkohe që mbështet institucionet në zbatimin e kornizave ligjore dhe politikave të ndjesme gjinore.

Misioni ka tre departamente programore: Departamentin për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Departamentin e Demokratizimit, dhe Departamentin e Sigurisë e Rendit Publik.

Të drejtat e njeriut dhe komunitetet

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve në Kosovë janë ndër objektivat kryesore të Misionit.

Misioni fokusohet në të drejtat e komuniteteve jo-shumicë duke avokuar për pjesëmarrjen e tyre të plotë në vendimmarrje, siguri, të drejtat gjuhësore dhe arsimimin e tyre. Misioni monitoron procesin e kthimit dhe ri-integrimit dhe avokon për të drejtat pronësore të personave të zhvendosur, grupeve të ceneshme dhe veçanërisht grave. Në këto fusha, Misioni monitoron dhe avokon për pajtueshmërinë e institucioneve me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e duhur të legjislacionit në fuqi. Si anëtar i Këshillit për Zbatim dhe Monitorim, i cili ka mandat të ruajë dhe mbrojë trashëgiminë kulturore dhe fetare, Misioni kontribuon në zbatimin e plotë të legjislacionit

për zonat e veçanta të mbrojtura dhe ofron trajnime adekuate.

Si një nga akterët kyç ndërkombëtar, Misioni shqyrton projektiligjet dhe dokumentet e politikave për pajtueshmëri me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimet e sundimit të ligjit si dhe monitoron zbatimin. Programi i Misionit për monitorim të proceseve gjyqësore monitoron rastet në të gjitha fazat në mbarë Kosovën për pajtueshmëri me standartet ndërkombëtare për gjykim të drejtë dhe të drejta të njeriut. Bazuar në këtë monitorim, Misioni publikon raporte që ofrojnë rekomandime praktike për institucionet dhe akterët e sistemit të drejtësisë për veprime korriguese, përfshirë rekomandime për trajnime dhe ndryshime legjislativë. Misioni gjithashtu forcon kapacitetet e institucioneve jo-gjyqësore dhe organizatave të shoqërisë civile për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të ceneshme, përfshirë viktimat e dhunës në familje. Misioni synon të nxisë dialogun dhe të ndërtojë kapacitetet e të rinjve për të mbrojtur, promovuar dhe zbatuar të drejtat e njeriut në jetën e tyre të përditshme përmes parimeve të sundimit të ligjit dhe qasjes në drejtësi.

Përveç promovimit të dialogut ndër-fetar, Misioni mbështet forcimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve fetare dhe pjesëmarrjen e tyre në mekanizmat lokale për siguri, si dhe promovon angazhimin e tyre në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm. Përveç kësaj, Misioni mbështet institucionet për të ri-integruar personat e riatdhesuar nga zonat e konfliktit.

Demokratizimi

Misioni ofron mbështetje për institucionet qeveritare në kryerjen e funksioneve të tyre individuale apo edhe si tërsë i një sistemi të integruar të qeverisjes së mirë. Misioni punon me Kuvendin e Kosovës, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, institucionet e pavarura, organet qeveritare dhe komunat për të rritur aftësinë e tyre për të ofruar shërbime publike efektive në mënyrë transparente, të përgjegjishme dhe plotësisht gjithëpërfshirëse. Misioni mbështet të gjitha nivelet e qeverisjes për të përmirësuar bashkërendimin ndërqeveritar përhartimin dhe zbatimin e politikave.

Puna e Misionit në Kuvend mbështet bashkëpunimin ndërpartiak përmes mekanizmave të tillë si Grupi i Grave, Grupi i Rinisë dhe një rrjeti të grave kryesuese të komisioneve, dhe mbështet transparencën dhe kapacitetet e tyre të brendshme përmes mbështetjes teknike këshillëdhënëse. Misioni ndihmon institucionet e pavarura si Zyrën e Auditorit, Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit në përputhje me standartet demokratike dhe përmirësimin e cilësisë së punës së tyre, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Misioni gjithashtu konsolidon proceset zgjedhore duke mbështetur trupat e menaxhimit të zgjedhjeve për të siguruar që zgjedhjet administrohen në mënyrë profesionale dhe të drejtë, duke

lehtësuar digitalizimin e procesit zgjedhor dhe transparencën e tyre më të madhe, si dhe duke ofruar këshilla ekspertësh për politikat dhe proceset zgjedhore.

Në nivel lokal, Misioni këshillon komunat për çështje të tillë si zhvillimi i buxhetit dhe proceset e auditimit, e-qeverisja, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, bashkëpunimi ndër-komunal, hartimi i ligjeve, hartimi dhe zbatimi i politikave, qeverisja mjedisore, si dhe zbatimi efektiv i së drejtës për qasje në dokumente publike dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënavë personale.

Misioni përpinqet të përmirësojë pajtueshmërinë e institucioneve mediatike, siç është transmetuesi publik, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media, me kornizën ligjore dhe rregullatore, vetë-rregullimin dhe standartet ndërkombëtare. Për më tepër, punon për të nxitur standartet dhe etikën profesionale të gazetarisë, dhe një mjedis më të sigurt përgazetarët, si dhe për të zgjeruar edukimin medial dhe informimin.

Misioni ka qasje gjithëpërfshirëse me qëllim të forcimit të pjesëmarrjes publike të organizatave të shoqërisë civile dhe të rinjve dhe kontributin e tyre në dialogun ndërmjet dhe brenda komuniteteve. Në veçanti, Misioni promovon pjesëmarrjen e barabartë dhe gjithëpërfshirëse të publikut në proceset e politikave dhe vendim-marrjes në të gjitha nivelet, me fokus të veçantë tek gratë e reja, të rinjtë që u përkasin komuniteteve jo-shumicë, të rinjtë me aftësi të kufizuar dhe ata nga zonat e largëta.

Në përputhje me angazhimet e OSBE-së, Misioni punon që të avancojë agjendat për Rininë, dhe për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, përfshirë edhe përmes nismave si Akademia e Dialogut përgjithës, Gra të Reja nga Prishtina dhe Beograd, organizuar së bashku me Misionin e OSBE-së në Serbi.

Puna jonë

(vazhdim)

Rendi dhe siguria publike

Misioni i ofron agjencive të sigurisë publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë mbështetje të shumanshme për të parandaluar dhe luftuar kércënimet e sigurisë dhe për të nxituar një mjetisë të sigurt për të gjitha komunitetet në Kosovë. Fokusohet kryesisht në mbështetjen strategjike dhe ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar shkathësitë e agjencive të sigurisë publike për parandalimin dhe luftimin e krimeve të rënda dhe të organizuara.

Misioni gjithashtu ofron ndihmë për të rritur shkathësitë e institucioneve të sigurisë publike në mjekësi ligjore, mbikëqyrje të policisë dhe punë policore operative speciale, si dhe në komunikim,

menaxhim të emergjencave dhe rehabilitim të personave të burgosur dhe integrimin e tyre të mëvonshëm në shoqëri. Gjithashtu, ofron ekspertizë dhe ndihmë këshillëdhënëse për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për konsolidimin e kapaciteteve të saj dhe kontrollin e brendshëm të cilësisë së programeve të trajnimit.

Për të nxituar dialogun ndërmjet komuniteteve dhe Policisë, Misioni punon për të zgjeruar partneritetin polici-qytetar, duke përfocuar aftësinë e forumeve të sigurisë në bashkësi për të trajtuar çështjet lokale të rendit dhe sigurisë në mbarë Kosovën. Misioni gjithashtu punon me strategjinë që kombinon punën policore në bashkësi dhe punën policore të udhëhequr nga inteligjenca, duke angazhuar policinë dhe forumet e sigurisë në bashkësi për luftimin



Për të ndihmuar në rritjen e sigurisë për të gjitha komunitetet në Janjevë, fshat piktoresk ku jetonë kroatë, shqiptarë, turq e romë, Misioni me mbështetjen e Ambasadës Kroate dhuroi kamerat CCTV për komunën e Lipjanit dhe stacionin lokal të policisë.


e kriminalitetit që ndikon në cilësinë e jetës së komuniteteve.

Misioni mbështet agjencitë e sigurisë publike dhe shoqatat profesionale të grave në rekrutimin, mbajtjen dhe posaçërisht shtimin e përfaqësimit të grave dhe komuniteteve joshumicë brenda strukturave të tyre, përfshirë fuqizimin e agjendës strategjike

të barazisë gjinore të polisë.

Misioni gjithashtu angazhohet me policinë dhe të rinjtë për parandalimin e delikuencës së të rinjve, veçanërisht për tema të tillë si abuzimi me drogën, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi, dhuna në shkolla dhe krimet e urrejtjes.

Fakte e shifra



Shef i Misionit

Ambasador Michael Davenport

Zëvendësshefe e Misionit

Cornelia Taylor

Personeli

491 poste, 115 staf ndërkombëtar dhe 376 vendor. Personeli i Misionit është i vendosur në selinë e OSBE-së në Prishtinë dhe në pesë qendra rajonale: Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

Buxheti

17,462,600 Euro

Ndiqni @OSCEKOSOVO



Misioni i OSBE-së në Kosovë

Rr. Abdyl Frashëri Nr.12
10000 Prishtinë

Tel: +383 38 240 100
OSCEKosovo-COMMS@osce.org
www.osce.org/kosovo
@oscekosovo